

# BOJAKËT



## FUGA 2+

2-8mm

| Ngjyra    | Paketimi  |
|-----------|-----------|
| 26 ngjyra | 2KG & 5KG |

### PËRSHKRIM

Mbushës për fuga dy komponentësh, me rezistencë të përmirësuar. Komponenti A(2Kg) përbëhet nga material pluhur me bazë çimento, rërë mermeri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe agjentë hidrofobikë. Komponenti B (200 g ) perbehet nga rezina akrilike çka jep produktit final fleksibilitet më të lartë, rezistencë të përmirësuar dhe mbrojtje maksimale ndaj agjentëve gërryes dhe detergjentëve.

I përshtatshëm për mbushjen e fugave nga 2-8 mm. I klasifikuar si produkt CG2WA në bazë të standartit EN 13888. Karakterizohet nga një punueshmëri dhe pastrim shumë i lehtë, ngjitje shumë e mirë.

### FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për mbushjen e fugave nga 2-8 mm.

### PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Fugat që do të stukohen duhet të jenë të pastra, pa ngjitës pllakash ose llaç në të gjithë trashësinë. Nuk rekomandohet aplikimi mbi bazamente të lagura.

### PËRGATITJA E PRODUKTIT

Fillimisht përzieni komponentin B (200g) me 400-500 ml ujë, kësaj përzjerje i shtojmë përmbajtjen e komponentit A (2kg). Përzjerja bëhet me një përzjerës elektrik derisa të arrini një masë homogjene dhe pa kokrriza.





### APLIKIMI

Aplikoni produktin në fuga me një shpatull gome ose me makinerinë shpatulluese. Pas 20 minutash kur produkti të jetë bërë i qëndrueshëm bëhet pastrimi i pjesës së mbetur me një sfungjer në mënyrë transversale me drejtimin e fugave.



## TË DHËNAT TEKNIKE

|                                                                           |                                                                 |
|---------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| <b>Pamja:</b> Komponenti A(pluhur), Komponenti B( lëng)                   | <b>pH i përzierjes:</b> 12                                      |
| <b>Paketimi:</b> Qese 2kg dhe Bidon 200g të ambalazuara në kovë prej 2 kg | <b>Temperatura e aplikimit:</b> +5°C deri në +35°C              |
|                                                                           | <b>Koha e punueshmërisë:</b> 1 orë                              |
| <b>Ngjyra:</b> I disponueshëm në 26 ngjyra                                | <b>Mbushja e fugave në dyshe:</b> Pas 24 orësh                  |
| <b>Magazinimi:</b> Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri            | <b>I shkëlshëm:</b> Pas 24 orësh                                |
| <b>Koha e magazinimit:</b> 12 muaj nga data e prodhimit                   | <b>Rezistenca në shtypje në 28 ditë:</b> 15N/mm <sup>2</sup>    |
| <b>Masa Vëllimore:</b> 1.5 gr/cm <sup>3</sup>                             | <b>Rezistenca në përkulje në 28 ditë:</b> ≥ 2 N/mm <sup>2</sup> |
| <b>Ujë për përzierje:</b> 1.2-1.6 litra ujë për 5 kg                      | <b>Rezistent ndaj:</b> Acideve, Bazave dhe Kripërave            |



Kujdes! Për suporte ku është kaluar hidroizoluesi dhe formate të mëdha pllakash vendosja e fugës bëhet 4-5 ditë pas aplikimit të kollës, në fund të bashkimit me murin aplikohet silikon me të njëjtën ngjyrë me fugën.